

Eficienca e buxhetit të Bashkisë Patos (Viti 2019)

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2019

Studimi ka për qëllim të analizojë eficiencën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2019, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifatat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve

Burimet e financimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	127,290	1,235,825	31.3%
Transferta e pakushtëzuar sektoriale (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	84,749	822,806	20.9%
Trasferta e kushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	3,985	38,689	1%
Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	190,042	1,845,068	46.8%
TOTALI	406,066	3,942,388	100%

Burimi: Bashkia Patos (llogaritje EIC)

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Patos 2019



Burimi: Bashkia Patos (Ilogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Patos për vitin fiskal 2019

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2019. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

Emërtimi i Shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Shpenzime për paga dhe sig.shoqërore	214,700	2,084,466	53
Shpenzime korrente	91,246	885,883	22
Shpenzime kapitale	100,120	972,039	25
TOTALI	406,066	3,942,388	100


Burimi: Bashkia Patos (Ilogaritje EIC)

Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Patos (Ilogaritje EIC)

Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale



Burimi: Bashkia Patos (Ilogaritje EIC)